

## Syllabusi i lëndës

**Lënda:** Gruaja dhe shoqëria

**Programi i studimit:** Studime Islame

**Numri i ECTS kredive:** 4

**Statusi i lëndës:** Zgjedhore

**Kodi i lëndës:** 407

**Fondi i orëve:** 2+0

**Viti akademik:** 2024-2025

**Semestri:** i -VII-të

**Mësimdhënësi:** Dr. Ilmije Kuqi

### Përshkrimi i lëndës:

Roli i gruas në shoqëri është i rëndësishëm. Nga ana e statistikave gruaja paraqet gjysmën e shoqërisë ndërsa nga ana funksionale edhe më shumë se gjysmën pasi që (si nënë) merret me edukimin e gjysmës tjetër. Pavarësisht kësaj, gruaja historikisht, deri me ardhjen e Islamit, ka qenë e përbuzur. Shkak kanë qenë bindje fetare dhe zakone të ndryshme shoqërore. Ky kurs në fokus ka trajtimin historik dhe analitik të këtyre bindjeve, për tu përqendruar më pas tek të vërtetat islame për femrën dhe, për të përfunduar me pozitën e femrës në kohën tonë dhe të drejtat e saja.

### Qëllimet e lëndës:

Qëllimi i lëndës '*Gruaja dhe shoqëria*' është që:

- të hedhë dritë mbi femrën pozitën dhe rolin e saj shoqëror historikisht
- të evidentojë bazën ideologjike të bindjeve dhe zakoneve të ndryshme përkitazi me femrën
- të hedhë dritë mbi të vërtetat islame për femrën
- duke qenë se shkelja e të drejtave të femrës dhe abuzimi me to ndodhë si shkak i mungesës së vetëdijes së femrës për të drejtat e saja dhe vetëdijes kolektive për femrën dhe të drejtat e saj, atëherë kursi synon të ngrit këtë vetëdije duke aftësuar studentët që të interpretojnë dhe transmetojnë njohuritë për femrën dhe rolin e saj në shoqëri.

### Rezultatet e pritura të nxënies:

Në përfundim të këtij kursi studenti i vlerësuar pozitivisht do të jetë në gjendje:

- të ketë një formim historik rreth të drejtave të femrës
- të njihet me të vërtetat islame përkitazi me femrën dhe të drejtat e saj
- të interpretoj tek të tjerët konceptin e kompletuar islam për femrën dhe të drejtat e saja

- të kontribuojë në avancimin e të drejtave të femrave në shoqërinë tonë.

### Metodologjia e mësimdhënies:

Lënda do të trajtohet në formë të ligjëratave, të cilat prezantohen para studentëve me anë të projektorit, që ta kuptojnë më lehtë dhe më qartë. Në fund të çdo ligjërate, do të rezervohet një kohë për të bërë një përsëritje rreth temës së shtjelluar dhe pyetjeve eventuale të studentëve. Gjithsesi se gjatë ligjërimit do t'i lihet hapësirë studentëve që të shprehin mendimin dhe pikëpamjen e tyre për programin e shtjelluar. Do të ketë edhe punime seminarike dhe prezantime individuale të studentëve rreth temave të caktuara paraprakisht.

### Plani i detajuar i mësimit:

Nr.	Java	Ligjërata / aktiviteti
1.	Java I	Njoftim i përgjithshëm me lëndën, literaturën, vlerësimin e studentëve, etj.
2.	Java II	<b>Femra para Islamit</b> <i>Në fokus të kësaj ligjërate janë motivet mbi bazë të të cilave është trajtuar femra në shoqëritë para dërgimit të Muhammedit a.s., peygamber. Ligjërata ofron përmbledhje për pozitën e femrës në:</i> <ul style="list-style-type: none"><li>- shoqëritë idhujtare (greke, romake, kineze, indiane, perse)</li><li>- shoqëritë fetare (hebraike dhe të krishtere), dhe</li><li>- shoqërinë arabe paraislamike.</li></ul>
3.	Java III	<b>Femra në Islam</b> <i>Temë kryesore e kësaj ligjërate janë bazat mbi të cilat Islami ka ndërtuar qëndrimin për femrën. Duke iu referuar ligjëratës paraprake, do të tërhiqen krahasime ndërmjet koncepteve.</i>
4.	Java IV	<b>Tekste të keqkuptuara rreth konceptit islam për pozitën e femrës</b> <i>Ekzistojnë disa ajete kur'anore dhe hadithe profetike të cilat nëse lexohen sipërfaqësisht mund të merren si dëshmi për kinse diskriminimin e femrës në Islam. Kjo ligjëratë merret ekskluzivisht me këto tekste dhe kuptimet e vërteta të tyre.</i>
5.	Java V	<b>E drejta edukative e femrës</b> <i>Arsimimi i femrës myslimane është një pikë në të cilën godasin kritikët dhe kundërshtarët e fesë. Kjo ligjëratë zbardh aspekte islame të arsimimit të femrës, respektivisht sjell argumente dhe dëshmi për arsimimin e femrës në Islam dhe rrjedhimisht flakë akuzat për kinse diskriminimin gjinor sipas fesë.</i>
6.	Java VI	<b>Mbulesa e femrës dhe zbukurimi i saj</b>

		<i>Mbulesa vazhdon të jetë temë e nxehtë. Nga disa perceptohet si simbol fetar, e nga të tjerë si mjet diskriminues ndaj femrës. Kjo ligjëratë i jep përgjigje këtyre dhe dilemave tjera rreth shamisë.</i>
7.	Java VII	<p><b>E drejta pronësore dhe trashëgimore e femrës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- A ia njeh Islamit femrës të drejtën e pronësisë?</li> <li>- Cili është qëndrimi islam për trashëgiminë e femrës dhe a përbën shkelje të të drejtave të saj?</li> </ul> <p><i>Janë pyetje këto që do të marrin përgjigjen e duhur në këtë ligjëratë.</i></p>
8.	Java VIII	<p><b>Testi intermedier - testi përfshin pesë ligjëratat e para me nga një pyetje për secilën ligjëratë. Testi mbahet në javën të cilën e përcakton dekanati, që nënkupton se data e mbajtjes së tij mund të lëviz një javë para ose mbrapa.</b></p>
<i>Java e testit intermedier mund të lëviz varësisht nga data që parashihet mbajtja e testit nga dekanati.</i>		
9.	Java IX	<p><b>E drejta predikuese e femrës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Cila është e drejta predikuese e femrës në Islam?</li> <li>- Cilat janë shpjegimet e dijetarëve myslimanë për akuzat për kinse mohim të kësaj të drejte nga meshkujt?</li> <li>- A lejohet femra t'iu prijë meshkujve në namaz?</li> <li>- A është diskriminim mos lejimi i saj për të qenë imam i kolektivit – xhematit?</li> </ul> <p><i>Këtyre dhe pyetjeve tjera do t'iu japim përgjigje në këtë ligjëratë.</i></p>
10.	Java X	<p><b>E drejta dhe detyrimi bashkëshortor i femrës</b></p> <p><i>Në kuadër të kësaj ligjërata trajtohen aspekte juridike islame sa i përket të drejtës së femrës për të përzgjedhur bashkëshortin, të drejtat e saja si bashkëshorte, detyrimet e saja si bashkëshorte.</i></p>
11.	Java XI	<p><b>Shëndeti riprodhues sipas mësimave islame</b></p> <p><i>Një nga gjërat që vazhdon të debatohet gjerësisht sot është edhe shëndeti riprodhues tek femrat. Ligjërata trajton termin, konceptin dhe ofron konceptin islam për çështjen në fjalë.</i></p>
12.	Java XII	<p><b>Poligamia dhe të drejtat e femrës</b></p> <p><i>Sa herë flitet për gruan dhe të drejtat e saja në Islam, poligamia zihet në gojë si kinse një formë me të cilën argumentohet për padrejtësi të fesë karshi gruas. Në këtë ligjëratë, të gjitha këto akuza, keqkuptime e keqinterpretime do të provohen si të gabuara. Zbërthimi fetar dhe shoqëror që i bëhet këtij fenomeni shoqëror në këtë ligjëratë ka një rëndësi të posaçme për studentët pasi që këta të fundit i mobilizon me dije dhe informacione të mjaftueshme rreth poligamisë historikisht, kulturalisht dhe fetarisht.</i></p>

13.		<p><b>Menaxhimi i problemeve bashkëshortore / Dhuna ndaj gruas</b></p> <p><i>Jeta bashkëshortore ka baticat dhe zbaticat. Kjo ligjëratë shpjegon nëse dhuna e burrit ndaj gruas është elementi me të cilin zgjidhen këto zënka a mosmarrëveshje, duke ofruar shpjegime të detajuara të ajeteve dhe haditheve që janë me këtë tematikë.</i></p>
14.	Java XIII	<p><b>Shkurorëzimi dhe të drejtat e femrës</b></p> <p><i>Shpeshherë flitet se shkurorëzimi është e drejtë ekskluzive e burrit. Kjo ligjëratë ofron shpjegim të drejtën e gruas në kërkimin fillimisht të shkurorëzimit, të drejtat e saja gjatë periudhës së pritjes, të drejtat e saja për përkujdesjen për fëmijët, etj.</i></p>
15.		<p><b>Gratë e veja në shoqërinë islame</b></p> <p><i>Në shoqëritë para islamike, vërejmë trajtim të padinjitetshëm të gruas së ve. Në këtë ligjëratë ofrohen aspekte teorike por edhe praktike të femrës së ve në shoqërinë islame, të cilat krahasohen me praktika të mëparshme por edhe të tanishme në shoqëri të ndryshme.</i></p>
16.	Java XIV	<p><b>Lëneshat: shkaqet, trajtimi dhe zgjidhjet</b></p> <p><i>Në kuadër të kësaj ligjëratë do të prezantohet një hulumtim i ligjëruesit të lëndës i zhvilluar në tërë territorin e Kosovës.</i></p>
17.	Java XV	<p><b>Trafikimi i femrave dhe qëndrimi i Islamit karshi prostitucionit</b></p> <p><i>Trafikimi me femra është një dukuri që po ngulfat shoqërinë. Ligjërata përpiket të hedh dritë mbi qëndrimin islam karshi kësaj dukurie dhe format preventive të tij në mënyrë që të ruhet dinjiteti i femrës dhe nderi i saj.</i></p>
18.		<p><b>Lëvizjet për emancipimin e femrës dhe të drejtat e propaganduara prej tyre</b></p> <p><i>Në këtë ligjëratë ofrohet një përmbledhje historike për lëvizjet për emancipimin e femrës, qëllimet e tyre, mjetet dhe disa të drejta kryesore që kanë qenë dhe janë kryefjalë e angazhimit të tyre, si: e drejta e femrës për pjesëmarrje në jetën publike duke u fokusuar tek punësimi (angazhimi në mësimdhënie me theks të veçantë duke ofruar shembuj të grave të ditura gjatë historisë), angazhimi politik dhe angazhimi ushtarak, ngacmimi seksual si pasojë e angazhimit të përbashkët të gjinive, etj.</i></p> <p><i>Në kuadër të kësaj ligjërata do të trajtohen edhe dokumente ndërkombëtare për të drejtat e femrës, të cilat do të krahasohen me mësimet islame.</i></p>
<b>Metoda e vlerësimit:</b>		
Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjëratë:		10%

Punimi seminarik: <i>Seminaret fillojnë që nga java e tretë. Studentët janë të lirë në përzgjedhjen e temave. Seminari duhet të ofrohet në format të shtypur dhe të prezantohet para studentëve.</i>	20%
Testi intermedier:	30%
Provimi final:	40%
Total:	100%

### Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studenti duhet të respektojë institucionin dhe rregullat e parapara:

- të respektojë orarin e ligjëratave;
- të mbajë disiplinën gjatë ligjëratave;
- t'i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimmshënësi;
- të mos mbajë të kyçur celular, apo aparate tjera gjatë orëve të mësimi.

### Literatura bazë:

Topalliogllu, Bekir, *Gruaja në Islam*, përktheu: Mithat Hoxha, (Stamboll: Universiteti Marmara, 2000).

Grup autorësh, *Femra nën mbrojtjen e Islamit*, (Prishtinë: Komiteti i Bashkuar Saudit – Ndihmë Kosovës, 2002).

Sibai, Mustafa, *el-Mer'etu bejne-l-fikhi ve-l-kanun*, (Bejrut: El-mekteb el-islamij, ed. 6, 1984).

### Literatura shtesë:

Kardavi, Jusuf, *Gruaja në Islam*, përktheu: Sadush Tahiri, (Prishtinë: Shoqata Bamirëse e Katarit, 2002).

Dr. Sherif Abdel Azīm - *Gratë në Islam kundrejt grave në traditën JudeoKristiane: Miti dhe realiteti*, Përktheu: Edin Q. Lohja, Botues: Conveying Islamic Message Society, Aleksandri 2008.

Gazali M., Tantavi M.S., Hashim A.U., *el-Mer'etu fi-l-Islam*, (Kajro: Ahbar el-jevni, 1991).

Afgani, Seid, *el-Islam ve-l-mer'eh*, (Bejrut: Dar el-fikr, ed.3, 1970).

Faruki, Lois Lamja, *Gratë, shoqëria myslimane dhe Islami*, përktheu: Mimoza Sinani, (Shkup: Logos-A, 2007).

Taha, Sabir Ahmed, *Nidhamu-l-usreti fi-l-jehudijeti ve-n-nasranijeti ve-l-Islam*, (Kajro: Nehdatu Misr, 2000).

Tahhan, Mustafa, *Gruaja në karvanin e thirrjes*, përkthyer: Bashkim Aliu dhe Sali Shasivari, (Shkup: Furkan ISM, 2001).

Nedvi, Ebu-l-Hasen Ali Nedvi, *Ma dha hasire el-alem bi-n-hitati el-muslimine*, (Indi: el-Mexhmeu el-islamij el-ilmij, 2008).

Zejjat, Habib, *el-Mer'etu fi-l-xhahilijje*, (Kajro: Muessesetu Hindavi, 2013).

Aktiviteti	Orë	Ditë\Javë	Gjithsej
<b>Ligjërata</b>	2	15	30
<b>Ushtrime teorike</b>	-	-	-
<b>Punë praktike</b>	-	-	-
<b>Kontaktme me mësimdhënësin\konsultimet</b>	1	10	10
<b>Ushtrime në terren</b>	-	-	-
<b>Kollokfiume, seminare, ese</b>	1	10	10
<b>Detyra të shtëpisë</b>	1	5	5
<b>Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)</b>	1	15	15
<b>Përgatitja përfundimtare për provim.</b>	5	4	20
<b>Koha e kaluar në vlerësim (teste, ese, provim final)</b>	2	5	10
<b>Totali</b>	<b>13</b>	<b>15 javë</b>	<b>100</b>